



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.02.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar".

2. Shqyrtimi i projektligjit "Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar".

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Elena Xhina dhe Silva Caka

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Fatmir Xhafaj, Damian Gjikhuri, Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Teuta Vodo – Zëvendësministre e Drejtësisë

Katrin Treska – Drejtoreshë e Përgjithshme e Drejtorisë Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë

Ermira Gjeçi – Zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Irfan Tarelli – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

Majlinda Bozgo – Përgjegjës Sektori në Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi plotësohet për të shqyrtuar dy çështjet që kemi sot në rendin e ditës:

E para, është shqyrtimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar". Relatorë të këtij projektligji janë kolegët Bashkim Fino dhe Klotilda Bushka.

Si pikë e dytë e rendit të ditës është projektligji "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar".

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Të dyja projektligjet janë nismë e deputetit Erion Braçe. Ne kemi bërë një prezantim dhe një diskutim në parim për të dyja këto nisma, por nuk i kemi votuar në parim.

Do të ketë një raportim për të dyja nismat.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen: nga Ministria e Drejtësisë, zëvendësministrja, zonja Teuta Vodo, drejtoresha e Përgjithshme e Drejtorisë Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, zonjën Katrin Treska dhe nga Ministria e Bujqësisë është zonja Ermira Gjeçi, zëvendësministre dhe zoti Irfan Tarelli, drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe zonja Majlinda Bozgo, përgjegjëse sektori në Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës. Nuk e di nëse janë të pranishëm të gjithë në komision, por të dyja zëvendësministret i kemi të pranishme sot në tryezën e komisionit.

Pa humbur kohë, do t'ia kaloj fjalën relatores, zonjës Bushka, për të bërë një prezantim të të dyja projektligjeve, meqenëse janë paketë dhe i referohen së njëjtës problematikë.

Fjala është për ju.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, kryetar!

Të dyja nismat e zotit Braçe kanë të bëjnë me ndryshime në dy ligje: në ligjin nr. 9948 të vitit 2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar" dhe në ligjin tjetër nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve".

Dua të risjell në kujtesë të komisionit që nismat e zotit Braçe janë paraqitur vitin e kaluar, kur në këtë mbledhje komisioni kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe të ekzekutivit, të cilët kanë parashtruar se shqetësimet, që adreson secila nga nismat e zotit Braçe për të dyja këto ligje, do të jenë pjesë e paketës së reformës së pronës për t'u adresuar me ligjin për përfundimin e proceseve kalimtare. Duke iu referuar situatës që ligji për përfundimin e proceseve kalimtare u shty për një periudhë të mëvonshme dhe nuk u miratuar nga Kuvendi, edhe pse u shqyrtua në komision për faktin se disa deputetë të maxhorancës kanë kërkuar kohë që të shohin problematikat në zonat e tyre elektorale dhe shqetësimet e banorëve të komuniteteve ku ata punojnë në lidhje me çështjet e të drejtës së pronësisë për tokën bujqësore, në mënyrë që të ezaurohet e gjithë problematika në ligjin për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, sepse ai do të jetë një ligj i cili do t'i japë fund tranzicionit në lidhje me këto çështje, do të jetë një ligj me afat, pra nuk mund të ketë më shtyrje të herëpashershme.

Nismat e zotit Braçe mbeten ende në veprim dhe për këtë arsye duhet që ky komision t'i marrë në shqyrtim. Në thelb, duke u nisur nga çfarë ka propozuar zoti Braçe, kemi të bëjmë me dy çështje: e para, ka të bëjë me shtyrjen e afatit për sa u takon kërkesave të subjekteve për t'u pajisur me aktin e marrjes së tokës në pronësi, dhe flasim për ato subjekte që e përdorin efektivisht tokën bujqësore, por nuk e kanë të plotë dokumentacionin e titullit të pronësisë, i cili duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore në fuqi, deri më 31.12.2018 ishte, nga institucionet përkatëse për titujt e tokës bujqësore. Tjetra ka të bëjë me disa situata problematike në Jug të vendit, konkretisht në rrethin e Divjakës, ku ka një problematikë të posaçme: brenda së njëjtës ish-kooperativë bujqësore banorë të kooperativës nuk e kanë marrë tokën nga komisionet e tokës në vendin ku ata efektivisht e kanë pasur gjendjen civile deri më 01.08.1991, siç parashikonte ligji për tokën, por e kanë marrë në një fshat tjetër brenda të njëjtit territor, por gjendja civile nuk përkon me vendin ku kanë tokën. Ka që në vitin 1991 që e përdorin tokën. Kanë akt përdorimi, ose e kanë të paplotë aktin e përdorimit, pra kanë kaluar mbi 20 vjet që janë përdorues faktikë të tokës dhe duhet patjetër të gjendet një zgjidhje me mekanizëm ligjor që këtyre familjeve t'u jepet titulli i pronësisë, sepse e përdorin efektivisht, e kanë përfituar brenda territorit të ish-kooperativës apo të ish-ndërmarrjes bujqësore, ku ata kanë qenë në periudhën që parashikonte ligji. Për këtë arsye duhet të gjendet një zgjidhje me mekanizëm ligjor, që nuk e parashikon ligji aktual. Të dyja ligjet, edhe ai "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", edhe ligji tjetër "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve

bujqësore në pronësi të përfituesve" kanë nevojë për dy ndërhyrje: për shtyrje të afatit dhe për saktësimin e zgjidhjes së problematikës së këtij grupi interesi që unë ju shpjegova për banorët e Divjakës, për familjet bujqësore.

Duke u nisur nga mënyra se si është paraqitur nisma e Braçes, ne kemi punuar në një grup pune edhe me vetë zotin Braçe bashkë me relatorin tjetër, zotin Fino, si dhe me përfaqësues të Ministrisë dhe kemi disa propozime për riformulime për sa i takon nismës së zotit Braçe që të dalë më e qartë ajo që kërkohet dhe të adresohet si shqetësim për zgjidhje nga këto dy nisma, por edhe në kuadër të teknikës legjislative. Keni përpara një raport për secilin nga ligjet. Në ligjin nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve" propozojmë, duke u nisur nga nisma e zotit Braçe, një riformulim të nenit 1 të projektligjit, ku do të shtojmë pikërisht kategorinë e përfituesve që i përgjigjen situatës së banorëve të Divjakës; do të kemi, gjithashtu, një riformulim të nenit 2, i cili ndryshon nenin 6 të ligjit aktual dhe ka të bëjë pikërisht me afatin për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve, i cili do të mbyllet më 31 dhjetor të vitit 2019. Ky është një afat më se i mjaftueshëm për t'u dhënë mundësi jo vetëm banorëve të zonës që përmenda, por të gjithë banorëve dhe të gjitha familjeve bujqësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, që sot e përdorin efektivisht tokën, por për efekt të neglizhencës, të mosdijenisë, për shkak se mund të ketë ndodhur që të ketë ndërruar jetë kryefamiljari, i cili ka aktin e marrjes së tokës në përdorim apo aktin e marrjes së tokës në pronësi dhe nuk e ka regjistruar dot në organet përkatëse për të marrë certifikatën e titullit, sepse nuk janë nxjerrë dëshmitë e trashëgimisë, sepse ata, që kanë të legjitimuar për të nxjerrë një dëshmi trashëgime, le të themi fëmijët apo pasardhësit, nuk kanë qenë të ndërgjegjshëm që duhet të kryhet ky veprim, kanë qenë emigrantë, afati ka kaluar dhe ne nuk mund ta lëmë këtë situatë pa zgjidhje sot, në vitin 2019. Ky afat është shtyrë më shumë se dy herë, por është momenti që ky afat të shtyhet një herë e mirë dhe të mos shtyhet më, sepse problematikat që kanë lindur deri më sot për sa i përket këtij procesi transitor për titujt e pronësisë për aktet e marrjes së tokës në pronësi do të zgjidhet me ligjin "Për përfundimin e proceseve kalimtare", i cili do të shqyrtohet së shpejti nga ky komision.

Gjithashtu, është e nevojshme të bëjmë një shqyrtim në nenin 2, të shtojmë një dispozitë kalimtare, sepse, duke qenë se afati i shqyrtimit ka përfunduar më 31.12.2018, na duhet patjetër ta rregullojmë situatën se çfarë ndodh me aplikimet, të cilat kanë qenë të papërfunduara deri në këtë

afat, ndërkohë aplikimet e reja nga 1 janari 2019 kanë mbetur pending, derisa ky ligj të hyjë në fuqi.

Këto janë situatat që rregullohen me ndryshimet që bëhen në ligjin nr. 171/2014. E njëjta gjë është edhe për ligjin nr. 9948, i cili flet për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore. Në këtë ligj, përveç çështjes së afatit, që është i njëjtë me ligjin e saposqaruar, kemi dy ndërhyrje: njëra ndërhyrje bëhet në nenin 1 të projektligjit, i cili do të ndryshojë nenin 17 të ligjit aktual, pra do të hiqet një fjali, e cila i ka penguar deri më sot banorët e zonës së Divjakës për të pasur të drejtën e tyre për të regjistruar titullin. Do të kemi një nen të shtuar 1/1, që do të ndryshojë nenin 18 për sa i takon afatit me përmbajtjen si vijon: “Verifikimi i titujve të pronësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, përfundon më 31.12.2019”. Ndryshimi i fundit ka të bëjë me dispozitën kalimtare, që është një nen i shtuar 1/2: “Praktikat në proces dhe të papërfunduara deri në datën 1 janar 2019, si dhe aplikimet e paraqitura deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra këtij që do të shqyrtojmë, konsiderohen të vlefshme.”

Këto janë ndryshimet me pak fjalë. Nëse keni ndonjë pyetje, jam e gatshme për sqarime.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka!

Si shprehet Ministria e Bujqësisë lidhur me nismat e zotit Braçe dhe sugjerimet e bëra nga relatorja?

**Ermira Gjeçi** – Ministria e Bujqësisë është dakord me propozimin e zotit Braçe. Nuk kemi asnjë koment.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Po Ministria e Drejtësisë?

**Teuta Voda** – Parimisht jemi dakord.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ligji është për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

**Fatmir Mediu** – Të gjitha ligjet që duhet të aprovojmë, duhet të jenë në përputhje me legjislacionin europian. A ka mundësi të më thoni se cilit legjislacion europian për të drejtën e pronësisë i jeni referuar dhe e keni bazuar këtë dakordësi tuajën, qoftë edhe në parim?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Mediu!

Kush do t'i përgjigjet zotit Mediu?

Po, zonja Bushka.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Përgjigjja nuk ka lidhje me përafrimin e legjislacionit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Është edhe relator i projektligjit.

**Klotilda Bushka** – Të dyja ligjet në thelb shtyjnë vetëm afatin dhe rregullojnë vetëm një situatë. Në procedurën e përafrimit të akteve tona apo të përputhshmërisë me të drejtën e zbatueshme në Bashkimin Europian, në thelb janë çështje, të cilat lidhen me afatin dhe me dispozitën kalimtare. Njëri nga rastet që shqyrtohet, nuk ndryshon në thelb asnjë parashikim të ligjit. Qëkur janë miratuar dhe janë shqyrtuar ligjet, kanë qenë ligje të cilat nuk kanë qenë në programin e analizës së përputhshmërisë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Naço.

**Nasip Naço** – Faleminderit!

Në relacion ju thoni se është në përputhje me Kushtetutën. Dua të di: me cilin nen të Kushtetutës? Duhet të jemi të saktë se jemi në Komisionin e Ligjeve.

E dyta, në nenet që na janë paraqitur, në pikën 3 thuhet zbatohen kriteret e vendimit të Këshillit të Ministrave. A ka qenë kjo praktikë edhe herët e tjera që në një nen të ligjit të vihet një VKM?

Ju faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Në cilën pikë thoni?

**Nasip Naço** – Në pikën 3 thuhet: “Për këto familje bujqësore ose për këtë individë zbatohen kriteret...”. Edhe në pikën “dh” të kësaj thote që citohet VKM-ja. Është teknikë inovative, e keni përdorur për herë të parë, apo ka qenë praktikë?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Naço!

Përgjigjen do ta japë relatorja.

Po, zonja Bushka.

**Klotilda Bushka** – Atëherë, ligji është në përputhje me Kushtetutën, pra nismat e Braçes janë në përputhje me Kushtetutën, për sa kohë që në aspektin procedural janë paraqitur nga

personat që kanë të drejtën e nismës ligjvënëse dhe janë në përputhje edhe me të drejtat e liritë e njeriut, që parashikon kreu përkatës i Kushtetutës për sa i takon të drejtës së pronës. Për sa u përket neneve, mund ta hapni Kushtetutën e ta lexoni vetë, se nuk do të bëjmë leksion juridiku këtu, se juristë jeni edhe ju.

E dyta, për sa i takon nismës së Braçes, që ju thoni se i referohet një VKM-je, jo më kot ju sqarova, por, siç duket, nuk më keni dëgjuar, se keni qenë duke hulumtuar nenet përkatëse, ju thashë që kemi bërë riformulime në nene. Nëse i lexoni riformulimet, nuk ka referencë në VKM dhe kemi përpara dy relatime që do të përkthehen në raporte, ku jepen propozimet tona dhe nuk ka referim në vendim të Këshillit të Ministrave, por ka referim vetëm në legjislacion.

E fundit është çështja e tabelës. Nuk është problem të bëhet edhe në formë tabelare, por ju kujtoj se jemi komision për dhënie mendimi, nuk jemi komision përgjegjës që të bënim ndryshime. Këto janë sugjerime që bën komisioni ynë, nëse miratohen nga ne. Do të jetë Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, i cili, nëse do t'i marrë në konsideratë, do t'i unifikojë në një tabelë edhe ndryshimet tona, edhe ndryshimet e kolegëve të tjerë të atij komisioni. Është e kotë që unë të shpjegoj procedurën.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zonja Bushka, por zoti Naço ka të drejtë, sepse këtu në këtë komision punohet me tabelë; është mësuar me ato ligjet e tjera me tabelë.

A ka pyetje të tjera, se do të kalojmë në fazën e diskutimeve?

Nuk ka pyetje, kështu që kalojmë në fazën e diskutimeve.

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Zoti kryetar, për procedurë, duhet t'ju kujtoj se ne përpara një muaji kemi kaluar dy projektligje në komisionin tonë, ligjin për kadastrën dhe ligjin e kalimit të problematikës së pronësisë, të cilën e diskutuam, e futëm në seancë plenare, por nuk u diskutua në seancë plenare për arsyet që tha kolegja ime relatores. Kjo do të thotë se dy nismat e zotit Braçe ishin në projektligjin për të cilin kemi diskutuar edhe nen për nen dhe e kemi paraqitur në seancë plenare. Nuk kaloi ai projektligj në seancë plenare. Me të drejtë deputetët e maxhorancës thanë që ta rishikojmë për më vonë. Çfarë po bëjmë sot?! Ndaj, po të kujtoj procedurën. Ti jepja kënaqësinë opozitës edhe sot të flasë, por sot ne kemi tërhequr ato dy amendamente, të cilat deputeti Braçe i ka depozituar para një viti, dhe po i sjellim në vëmendje duke i hequr nga konteksti i ligjit që nuk e kaluam, i cili ishte në tentativë në parlament, pra i kalimit të problematikës së pronave. Kjo do të thotë se diskutimet në parim dhe në tërësi të projektligjet janë bërë. Këtu flitet thjesht për të



kaluar 2 nenet përkatëse të këtyre dy neneve përkatëse të këtyre dy nismave. Për këto dy nene, kur të votohet nen për nen, deputetët të bëjnë sugjerime dhe të bëjnë vërejtje. Në qoftë se ju do ta riktheni edhe një herë diskutimin në parim, kjo çështja juaj, por më lejoni t'ju kujtoj se po shkelni Rregulloren, sepse është bërë një herë një diskutim i tillë.

Ju faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Në fakt, pavarësisht se ne i kemi miratuar ato dy ligje në paketë në Komisionin e Ligjeve, këtu kemi të bëjmë me dy nisma të zotit Braçe, për të cilat diskutimi në parim nuk është ezauruar. Kështu që unë do të vazhdoj me këtë pjesë të Rregullores.

Fjalën për diskutim e ka kërkuar zoti Mediu.

Pastaj do të flasë zoti Hyseni.

**Fatmir Mediu** – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të them që në fillim se ky ligj është antikushtetues dhe vjen si pasojë e të gjitha ligjeve antikushtetuese, që janë miratuar më të drejtën e pronësisë, si ai për kthimin e tokave bujqësore në pronësi të atyre që u është dhënë në përdorim, edhe ligjeve të tjera që kanë qenë më parë, ligji nr. 7051 etj. Ky ligj bie ndesh me nenin 41 të Kushtetutës, i cili përcakton qartësisht se çfarë është prona private dhe si tjetërsohet për interes publik prona private. Tjetërsimi i tokave të fermave bujqësore, duke i dhënë në pronësi të punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore, nuk ka asgjë të përbashkët me këtë nen të Kushtetutës që përcakton raportet me të drejtën e pronës. Ligji për dhënien në pronësi të tokave të fermave bujqësore, pas marrjes në përdorim, është sa antikushtetues, por po ju them se është edhe korruptiv, edhe antisocial.

Janë mbi 8 mijë të vrarë, të nderuar kolegë deputetë, për shkak të çështjes së pronësisë në Shqipëri. Pra, është një dramë jashtëzakonisht e madhe sociale që kanë ndodhur në vendin tonë për shkak të padrejtësisë dhe interesave politike në këtë vend, që janë edhe interesa korruptive. A e dini se cilët janë pronësuar me ligjin për fermat bujqësore? Shoferë të drejtorëve të ish-ndërmarrjeve bujqësore; agronomë, të cilët kanë jetuar nëpër qytete dhe nuk kanë asnjë lidhje me pronën; punonjës të institucioneve bujqësore, të cilët kanë qenë nëpër qytete, por nuk kanë pasur asnjë lidhje me pronën. Pra, janë njerëz që nuk kanë pasur të bënin aspak me tokat e fermave bujqësore, por kanë punuar dikur. Në këtë koncept, i bie që gjithsecili nga ne, të marrë pikërisht atë pjesë të pronës ku punuar. Kjo është tërësisht alogjike, e papranueshme dhe antikushtetuese.

Jo vetëm nuk po pranoni atë parimin leninist që toka i takon atij që po e punon, por më keq, keni shkuar edhe më tej dhe thoni se toka i takon që ia jep partia apo deputeti.

Kjo është antieuropiane, antikushtetuese, antiligjore dhe është tërësisht korruptive. Në qoftë se doni jua sjell me fakte që punonjës të Institutit Bujqësor në Lushnjë, nga vjen edhe deputeti, të cilët jetojnë në Tiranë, nuk jetuar asnjë ditë në tokat e fermave bujqësore dhe kanë marrë në përdorim dhe më tej në pronësi tokat e fermave bujqësore, të cilat ua kanë dhënë fshatarëve t'i përdorim dhe marrin interesat e tyre financiare, pa pasur asnjë lidhje dhe asnjë mundim. Po ju kujtoj se janë 120 mijë hektarë që kanë fermat bujqësore, i kanë pasur si toka, të cilat kanë qenë rreth qyteteve. Pjesa më e madhe e tyre janë tjetërsuar tashmë në troje ndërtimi dhe në toka industriale për zhvillimin e biznesit. Pra, kanë përfituar në mënyrë abuzive, korruptive për interesa politike njerëz që nuk kanë lidhje me të drejtën e pronësisë. Ata kanë kaluar edhe më tej, duke përfituar shumëfish nga pikëpamja financiare për shkak të zhvillimit të këtyre pronave, ndërsa pronarët presin dhe nuk e marrin atë që u takon. Kjo është tërësisht abuzive dhe unë mendoj që një herë të vetme të paktën, duke lënë mënjanë ndjesitë dhe raportet personale, por qoftë edhe interesat konjunkturale korruptive, të ulemi e të mendojmë se çfarë po bëjmë me këtë çështje. As nuk duam ta lexojmë vendimin e Gjykatës së Strasburgut, as nuk duam të shikojmë situatën e pronësisë në Shqipëri, përkundrazi, e përkeqësojmë gjithnjë e më shumë.

Të nderuara kolege deputete, është e disata herë që thuhet se është hera e fundit që i shtyjmë ligjet për pronësinë për përcaktimin e titullit të pronësisë. Është hera e disatë dhe nuk zhvillohet në mënyrë të drejtë, nuk mbaron asnjëherë, sepse është tërësisht një ligj antikushtetues dhe i padrejtë. Ne si deputetë nuk kemi të drejtë që ta marrim tokën nga pronarët dhe të pronësojmë disa të tjerë. Për më tepër që ky ligj kërkon t'i pronësojë me dhunë dhe në kundërshtim me ato ligje që janë miratuar. Në vend që këto toka të vihen si fond i kompensimit apo kthimit të pronave pronarëve të ligjshëm, i çojmë edhe më tej, t'jua japim atyre që nuk u takon, që i marrin sipas interesave politike dhe konjunkturës politike. Nuk mund të shikohet drejta si numër votash. E drejta është përcaktuar si e drejtë. Prandaj po them se ekonomia shqiptare, investimet e huaja dhe zhvillimi ekonomik i këtij vendi ka mbetur në vend numëro dhe një nga arsyet e mëdha është pikërisht çështja e pronësisë në Shqipëri, e cila po shkon në kalvare pa fund në kundërshtim me të drejtën e pronës dhe në kundërshtim me lirinë dhe të drejtat europiane të përcaktuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ne nuk jemi Zoti që të përcaktojmë se cilat janë liritë dhe të drejtat e qytetarëve. Nuk mund të veprojmë sipas interesave e qejfeve tona politike për të realizuar

deri në fund një ligj, i cili është tërësisht korruptiv dhe antikushtetues. Prandaj mendoj se ky ligj jo vetëm që nuk duhet të miratohet, por ne si Komision Ligjesh kem detyrimin të shikojmë të gjithë legjislacionin për pronën për përputhshmërinë me Kushtetutën dhe ta kthejmë në binarët kushtetues.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Mediu!

Fjalën e ka kërkuar zoti Hyseni për diskutim.

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti kryetar!

Fatkeqësisht apo fatmirësisht, nuk jam dakord me konkluzionet e kolegut Mediu. Unë nuk ndaj mendimin që ky ligj është antikushtetues. Përkundrazi, për këtë mund të sjell një argument që është aq kushtetues, sa partia e zotit Mediu ka qenë financuese kryesore e kësaj Kushtetutë dhe ka pasur orë pa fund diskutime për atë Kushtetutë dhe është arritur një konsensus i madh që përcaktimet në këtë Kushtetutë të ishin në përputhje me aktet më të avancuara ndërkombëtare në fushën e të drejtës së pronësisë. Ndërkohë, kishte dalë legjislacioni qoftë për pajisjen me aktin e marrjes së tokës në përdorim për ish-kooperativat, po ashtu edhe për ish-ndërmarrjet bujqësore. Pra, kemi të bëjmë me një akt kushtetues të dalë pas legjislacionit përkatës të pronësisë, ndërkohë në vite, në kohën kur partia e zotit Mediu ka qenë në aleancë të vazhdueshme në qeveri të ndryshme të së djathtës, ka pasur të njëjtat ndryshime ligjore që po na paraqiten sot për shtyrje afatesh, për rregullime procedurale në dokumentacionin konkret për pajisjen me tituj pronësie. Po ju them se në vite janë bërë me dhjetëra ndryshime në vite, ndoshta numrin ekzakt nuk po jua them, por janë së paku 12 ndryshime ligjore, mot a mot si këto ndryshime të sotmet. Diskutime teknike procedurale mund të ketë për ndonjë nen të caktuar. E rëndësishme është që me këto ndryshime zgjidhen një ngërç praktik dhe faktik i atyre njerëzve, të cilët tokën e shohin si mënyrë për të fituar bukën e fëmijëve të tyre; e shohin si asetin e vetëm që e kanë fituar jo thjesht nga një ligj i dhënë që në fillim të viteve '90, me ndryshimet e sistemit, por e kanë fituar me djersën, mundin dhe kontributin e tyre e familjeve bujqësore në vite në atë ish-kooperativë apo ish-ndërmarrje bujqësore. Nuk janë parime leniniste parimet ku njerëzit kanë të drejtën për të siguruar të ardhmen e tyre aty ku kanë zgjedhur të jetojnë. Nëse kanë zgjedhur të jetojnë në fshat, patjetër që aty do ta ndërtojnë jetesën e tyre.

Të nderuar kolegë, në fshat në përgjithësi jetesa realizohet nëpërmjet tokës. Mund të ketë edhe familje që e realizojnë ndryshe, por shumica dërrmuese në Shqipëri, në vendet më të zhvilluara europiane dhe euroatlantike, por edhe në vendet të tjera me tokën e ndërtojnë atë. Ne

duhet t'u japim atyre atë që u ka dhënë ligji, por maliqët në vite i kanë zvarritur, i kanë telendisur dyerve të administratës, dyerve të ish-komunave, dyerve të kadastrave dhe hipotekave, dyerve të gjykatave dhe përsëri nuk e kanë gjetur të drejtën, ndërkohë që janë posedues prej 20 vjetësh, një pjesë e tyre edhe më tepër, duke e përfituar me të gjithë të drejtën morale, por edhe ligjore, duke llogaritur institutin e parashkrimit, ne kemi detyrimin që të mos i lëmë ata ta zgjidhin me gjykata me vite, por të saktësojmë aspektet procedurale për t'i bërë ata pronarë edhe juridikisht. Këtë bëjnë këto ligje.

Së pari, shtyjnë afatin, që është e thjeshtë, se është matematikë. Duke qenë se për shumë arsye, për shkak edhe të reformës territoriale në Shqipëri, e cila solli efekte jo të mira në aspektin e pronësisë, për shkak të transferimit të arkivave, të kompetencave nga ish-komunat në bashki nuk u realizua në afat dhe nuk ka asgjë ta shtyjme deri në fund të këtij viti.

Nga ana tjetër, kanë gjetur zgjidhje kategori, të cilat kanë qenë *de facto* në këto ndryshime, por janë trajtuar me to, pra në mbështetje të zotit Mediu tashmë, ata që kanë aty realisht dhe sot janë të lidhur me tokën dhe u takon të jenë. Unë jam dakord me pjesën e propozimit që njerëz, të cilët kanë jetuar në qytet ndoshta nuk duhej t'u ishte dhënë tokë në fshat, por këtë nuk e kemi bërë ne, por e ka bërë qeveria e zotit Mediu, kur ka qenë në pushtet. Ligji për pajisjen me tokë të ish-ndërmarrjeve bujqësore ka dalë në kohën e qeverisë së zotit Mediu, pa e gjykuar, por mund ta saktësojmë. Mund t'jua jap edhe numrin, edhe datën dhe besoj se biem dakord që në atë vit ka qenë qeveri e djathtë.

Të nderuar kolegë, unë kam një rezervë me ndryshimin që parashikohet në pikën "c", ku afati i transferimit të gjendjes civile lihet edhe pas datës 01.08.1991. Unë kam rezerva dhe kërkoj edhe mendimin e relatorëve sa e konsultuar është kjo situatë, sidomos mendimin e ministrisë, ku në diskutimet e mëparshme që kemi pasur, ministria ka qenë shumë e kujdesshme për të mos e hapur këtë derë, sepse së pari, ne vëmë në pozitë të pabarabartë ish-banorët e kooperativave bujqësore, të cilët kanë qenë ndoshta edhe ish-themelues, kanë dorëzuar tokën për të themeluar kooperativat bujqësore. Duke qenë se nuk kanë qenë banorë më 01.08.1991, ata nuk kanë përfituar tokën bujqësore, ndërkohë ne vëmë në pozitë më të favorshme ish-ndërmarrjet bujqësore. Pra, nuk më duket e drejtë.

Së dyti, kemi një aspekt praktik procedural. Të vetmet arkiva të pacenuara ishin arkivat e gjendjes civile. Cili do të jetë dokumentacioni që do të shërbejë për të verifikuar nëse ky ka qenë punëtor në ndërmarrje bujqësore, kur shumica e ndërmarrjeve bujqësore nuk e kanë më arkivin,

ose është djegur në vitin 1997, ose është zhdukur ndër vite nga keqadministrimi? Shumica e ndërmarrjeve nuk e kanë. Duke qenë se ne e shtyjme afatin dhe themi: “Se këta mund ta përfitojnë, mjafton të mos kenë përfituar tokë më parë” dhe jam dakord me këtë, sepse nuk mund të pajisen dy herë, por cilitdo dokument t’i referohemi, do të sjellim në praktikë një ngërç dhe do të hapim orekse të njerëzve, të cilët mund të jenë kthyer në fshat pas 10 vjetëve. Kështu siç e kemi riformuluar ne, ata mund të kthehen edhe tani në fshat dhe të thonë: “Unë kam qenë ish-themelues, meqenëse ligji atëherë më ndalonte, sot ligji ma jep të drejtën”, sepse kështu e ka ligji, ka ish-themeluesit dhe ish-punonjësit. Prandaj, unë them që ne si Komision Ligjesh duhet të jemi të kujdesshëm, të japim këtë sugjerim, pastaj le të diskutohet në mënyrë më të detajuar dhe profesionale në komisionin konkret, por gjykoj se te ky parashikim duhet të jemi të kujdesshëm. Duke e mbështetur fuqimisht ligjin dhe duke ruajtur rezerva vetëm për këtë parashikim, unë ftoj të gjithë kolegët që ta miratojnë sa më shpejt këtë ligj, sepse në praktikë ka një bllokim të situatës, ku ka mijëra dosje, të cilat kanë mbetur të bllokuara si pasojë e afatit. Prandaj ne duhet t’i hapim rrugë këtij procesi një orë e më parë. Nëse i bie thartë dikujt, dua t’i them se ky ligj është sa juridik, kushtetues, por edhe politik. Është akt politik, sepse ne u kemi premtuar njerëzve, të cilët jetojnë me tokën bujqësore, që do t’i mbyllim problemin e pajisjes me aktin e marrjes së tokës në pronësi. Ne e pranojmë që kjo është politike dhe nuk është e gabuar, është politika më e drejtë e mundshme, së pari, për njerëzit në nevojë dhe, së dyti, të mbash premtimet, qofshin ato edhe elektorale. Nga ana tjetër, ky nuk është thjesht një premtim elektoral, por është një premtim programor i Partisë Socialiste, e cila është pranë fshatarëve, pranë njerëzve që e punojnë tokën dhe pranë kategorive të tjera.

Faleminderit!

**Fatmir Mediu** – A mund të përgjigjem, meqenëse më përmendi disa herë?

**Ulsi Manja** – Zoti Mediu, jemi në fazën e diskutimeve dhe diskutim mbi diskutim nuk ka, por mund ta merrni fjalën.

**Fatmir Mediu**- Së pari, dua t’i kërkoj kolegut deputet që kur të referohet, të paktën, të lexojë, meqenëse është i ri në Kuvendin e Shqipërisë dhe nuk i di as nismat që janë marrë dhe as debatet që janë bërë për këtë çështje, si në qeveri, ashtu edhe në parlament.

Po ju kujtoj nenin 41 të Kushtetutës, që duhet ta lexoni të gjithë, i cili thotë: “E drejta e pronës private është e garantuar ( pra është e garantuar me Kushtetutë). Prona fitohet me dhurim, me trashëgim, me blerje dhe me çdo mënyrë klasike të parashikuar në Kodin Civil ( që nuk është

në asnjë rast e tillë). Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e të drejtës së pronës vetëm për interesa publike (vetëm për interesa publike dhe jo private të kujtdo apo për interesa politike, siç flitet). Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës, që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (nuk kemi asnjë rast të shpërblimit të drejtë në raport me të drejtën e pronësisë, që është sipas vlerës së tregut në ligjet për pronësinë). Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë (50 mijë çështje janë sot në Gjykatën e Lartë, sepse nuk ka Gjykatë të Lartë).”

Kjo kushtetutë dhe ky nen është vendosur pikërisht nga ne, në atë kohë, në mënyrë që të garantohet të drejtën e pronës private dhe të korrigjonim padrejtësitë që ishin bërë me ligjin nr. 7501 dhe me ligjin për feramat bujqësore, por, për fatin e keq, për shkak të interesave politike dhe interesave korruptive, duke i parë njerëzit thjesht si numër votash dhe jo si njerëz që duhet të gëzojnë të drejtat. Me këtë koncept që ju keni sot, koncept leninist, që toka i takon atij që e punon, keni arritur të shkatërroni të drejtën e pronësisë në Shqipëri. Të gjitha palët politike, të cilat kanë qenë në qeveri, kanë qenë për interesa politike, elektorale dhe koniunkturale korruptive.

Unë po jua them edhe një herë tjetër se ka deputetë në Kuvendin e Shqipërisë që kanë prona në feramat bujqësore, deputetë që s’kanë asnjë lidhje me pronën, ka drejtorë ndërmarrjesh, ka shoferë ndërmarrjesh dhe specialistë që nuk e kanë parë asnjëherë të vetme tokën. Në qoftë se kërkoni t’u jepni tokë atyre, të cilët nuk i kanë marrë titujt e pronësisë dhe feramat bujqësore, pse nuk kërkohet të bëjmë një rishikim të të gjithë legjislacionit për të parë titujt e pronësisë të atyre që kanë përfituar me pa të drejtë dhe që nuk kanë asnjë lidhje me tokën bujqësore, e gëzojnë këtë tokë, madje e kanë tjetërsuar, në kundërshtim edhe me ligjet që miratoni ju, për t’i kthyer në toka truaj me përfitime të majme, të jashtëzakonshme, edhe në kundërshtim me ligjin? Këto tjetërsime të bëra në kundërshtim me ligjin duhet të kishin pasur ndëshkime, që nuk janë bërë.

Për sa i përket raportit politik, personal timin, dhe të Partisë Republikane, po ju them se janë 6 nisma ligjore për të drejtën e pronësisë në këtë Kuvend, që i keni hedhur poshtë ju. Çdo ligj i ardhur, në qeveri kur kemi qenë apo në opozitë, në kundërshtim me të drejtën e pronës, është votuar kundër nga të gjithë përfaqësuesit e Partisë Republikane.

Edhe një herë, po ju them se të gjitha ligjet...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ti nuk ke kurajë të dalësh kundër partisë, Erion Braçes, do të më kërkosh mua pse nuk dal nga qeveria.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sepse je në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe një herë, unë po flas për pjesën e parë, pastaj për vlefshmërinë e titujve shko vërtetoje deri në fund. Ai titull që ke dhënë ti për pronësinë është në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjin.

Ju keni shtuar edhe diçka tjetër, që lidhet me aferat korruptive të qeverisë suaj, që doni të parashikoni, edhe jashtë asaj që ka thënë zoti Braçe, objekt investimi strategjik, sipas legjislacionit në fuqi, për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë, për interesa private. Ne e dimë se cilat janë interesat strategjike për zhvillimet në Shqipëri deri sot, të gjitha investimet, të cilat kanë një koniunkturë politike dhe interesa private lidhur me qeverinë tuaj, asnjë gjë që ka të bëjë me të drejtën e pronësisë apo me shpronësimin për interes publik, por për interesa private. Interesi privat nuk është pronësi publike. Interesi publik është i përcaktuar qartësisht se çfarë është.

**Ulsi Manja** –Faleminderit, zoti Mediu!

E zgjata shumë diskutimin, sepse shtyrje afati është. Në fakt, ligji nr. 9948, datë 07.07.2008, ka 11 vjet që është në fuqi, dhe çfarë kemi bërë ne në gjithë këto vite? Të paktën për sa kohë që unë jam deputet, çdo vit vlefshmëria e titujve ligjorë vinte për shtyrje afati. Ne në vitin 2008 nuk kemi qenë në pushtet. Pra, ligji u miratua në vitin 2008 dhe deri në vitin 2013 është bërë e njëjta procedurë vit për vit, madje relator pas vitit 2013, disa herë ka qenë kolegu Fino. Çfarë kemi bërë deri tani?! Asgjë, të njëjtën gjë po bëjmë, afatin po e çojmë më 31.12.2019, as po i marrim pronën kujt dhe as nuk po i japim pronën kujt, thjesht po u krijojmë mundësi qytetarëve shqiptarë që të bëhet verifikimi i titujve të pronësisë, por edhe regjistrimi i këtyre titujve.

Fjalën e ka kolegia Bushka.

**Klotilda Bushka** – Më vjen keq që e kaloni në një debat tërësisht politik dhe duket sikur nuk po flisni për çfarë parashikon rendi i ditës, por për një situatë hipotetike që e keni në kokë.

Në fakt, sot po flasim për një ndryshim në 2 ligje aktuale, njëri i bërë në kohën kur opozita ishte në maxhorancë dhe tjetri në vitin 2014 për t'i dhënë fund pikërisht atyre krahurave që ishin bërë gjatë qeverisjes së mëparshme me këto abuzime që thoni ju, për të cilat jam shumë dakord që kanë ndodhur dhe që sot janë procese të tëra hetimore në prokurori, ku shumë nga ata janë para ligjit për abuzime me këto çështje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk po ju them që kjo nuk është e vërtetë, kjo ekziston, por çështjet janë në hetim. Ne sot kemi një situatë komplet tjetër. Ju po ngatërroni situatën që keni në kokë me situatën që po ndodh sot. Sot po flasim për një kategori që efektivisht e përdor tokën dhe do ta marrë, që nuk është e parashikuar në ligj, për të zgjidhur një situatë praktike që ka ndodhur.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, më lini të flas!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sepse po jua shpjegoj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sepse ajo që jeni duke thënë ju nuk ka lidhje me çfarë po bëjmë ne dhe çfarë po adresojmë ne sot këtu.

Neni 41 i Kushtetutës flet për mënyrat sesi fitohet pronësia, të cilat janë të parashikuara në Kushtetutë dhe në Kod Civil. Edhe fitimi i pronësisë me një akt administrativ, me një të drejtë të njohur të ligjshme është një nga këto mënyra.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E keni parashikuar në ligjin që keni miratuar kur keni qenë ju, zoti Mediu.

Jam dakord me shqetësimin që ata, të cilët e përdorin efektivisht nuk do të duhet të cenojnë të drejtat e të tjerëve, siç janë pronarët e ligjshëm, por në ligjin aktual në nenin 2 është e parashikuar qartësisht, ku thuhet do të përjashtohen që të përfitojnë titull mbi tokën bujqësore ata subjekte, të cilët, për pronat që pretendojnë...,ku jepet një kategori përjashtimesh si: është regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme të zyrës së regjistrimit si pronë private në emër të një subjekti tjetër, kjo nuk do të ndahet si tokë bujqësore dhe, pa diskutim, do të prevalojë e drejta e pronarit privat duke garantuar Kushtetutën; nuk do të përfitojnë ato subjekte, të cilat tokën, që duan ta përdorin si tokë bujqësore, e kanë në proces legalizimi, sipas ligjit për legalizimin; nuk do të përfitojnë tokë bujqësore ata që përdorin një tokë, e cila është objekt kërkese që po shqyrtohet nga ATP-ja, por që nuk është dhënë ende vendimi, garantohet e drejta e ish-pronarit nëse ka një pretendim për tokë bujqësore nga një subjekt tjetër; janë dhënë me qira, në bazë të ligjit për dhënie me qira të tokës bujqësore dhe pyjore. Pra, do të përjashtohen edhe këto dhe, sigurisht, do të përjashtohen edhe ato toka, ku do të ketë investime strategjike për rrugë, hekurudha apo për vepra publike, të cilat u shërbejnë interesit publik. Nuk mund të priset një vepër e interesit publik për të marrë dikush një tokë bujqësore. Por çfarë është jashtë kësaj kategorie, çfarë përdoret efektivisht



sot nga fshatari dhe, nëse ka mangësi në titull, patjetër që fshatari, jo vetëm nga nisma që po shqyrtojmë sot, por nga çfarë parashikon ligji aktual, ka të drejtë ta përfitojë. Ky afat ka mbaruar dhe nuk është çudi që po e shtyjme prapë, sepse, tek e fundit, fshatarët duam të ndihmojmë. Aferat korruptive hiperbolike që keni në kokë, nuk i keni keq, sepse ju nuk duhet t'ju gjykojmë kur na thoni se ligjin e kemi në bazë të çështjeve klienteliste, të korrupsionit, të asaj që ne paskemi të fshehur si qëllim nëpër rreshta, nuk duhet të ofendohemi kur na thoni këtë gjë, por kur ju themi: “Pritni një sekondë, sepse e keni hiperbolike”, ju ofendoheni dhe ngrini zërin. Nuk është kjo situata, ne ose duhet të vëmë një rregull dhe të jemi të qartë se çfarë po flasim, ose të diskutojmë për problemet që ju thoni, për të cilat unë jam dakord që ekzistojnë, sepse ju thashë që ka disa çështje në prokurori, të cilat po hetohen, por nuk kanë lidhje me këto që po shqyrtojmë ne sot. Të gjitha shqetësimet që keni dhe janë të drejta, për sa i takon asaj që të mos cenohet e drejta e pronësisë së subjekteve që mund të kenë pretendime, procese e të tjerë për tokat bujqësore, të cilat mund t'i marrë sot fshatari dhe e përdor sot e efektivisht, por nuk ka titull pronësie, janë të ezaurura në legjislacionin aktual. Kjo është situata, prandaj them që ne po e hiperbolizojmë, sepse nuk po i përgjigjemi me diskutime asaj situatë, që nismat dhe riformulimet që ne i kemi bërë kërkojnë sot të adresohen si shqetësime për zgjidhje. Më fal, zoti kryetar, por është diskutimi i tillë.

**Ulsi Manja-** Faleminderit, zonja Bushka!

A ka diskutime të tjera?

Zonja Hysi, fjala për ju. Ju lutem, sa më shkurt, sepse jemi komision për dhënie mendimi!

**Vasilika Hysi-** Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, është e disata herë që e ndryshojmë këtë ligj dhe gjithmonë e kemi diskutuar që përmirësimi i ligjit është një aspekt, por problemi tjetër është njohja dhe zbatimi i tij.

Ky vit është vit zgjedhjesh në organet e qeverisjes vendore dhe në dispozitën kalimtare thuhet që praktikat në proces, të papërfunduara deri në datën 1 janar, si dhe aplikimet e paraqitura deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, konsiderohen të vlefshme. Shqetësimi im është sesi do të arrihet që këto ndryshime ligjore të shkojnë pikërisht tek ata përfitues, jo vetëm në Divjakë, por edhe në të gjithë Shqipërinë, sepse periudha, sikurse e thashë, përkon edhe me zgjedhjet, edhe me sezonin turistik dhe nuk do të doja që të vijmë prapë në fund të vitit dhe të themi: “Kanë mbetur shumë fermerë që nuk kanë mundur të zgjidhin këtë problem”. Këtë diskutim e kemi bërë në të gjitha shtyrjet që ne i kemi bërë ligjit. Përveç angazhimit që duhet të ketë ministria, besoj se bashkë duhet të luajnë një rol të rëndësishëm dhe ndoshta nënkomisioni që drejton zoti Fino për

organet e qeverisjes vendore mund të bëjë një seancë dëgjimore dhe informimi për t'i angazhuar të gjitha bashkitë, sepse periudha deri në hyrjen në fuqi të ligjit është shumë e shkurtër dhe mbledhja e dokumentacionit, e cila duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe jo abuzive, do të merrte shumë kohë. Prandaj e shoh shumë të rëndësishme, jo thjesht miratimin e ligjit, por informimin dhe krijimin e të gjitha lehtësirave për të gjithë fermerët kudo në Shqipëri që të marrin dokumentet në kohën e duhur. Ndoshta më vonë, zoti kryetar, ne si komision bashkë me komisionin përgjegjës duhet ta monitorojmë këtë proces dhe të mos kemi më ligje të tilla, të cilat vazhdimisht shtyhen, sepse organet e qeverisjes vendore nuk funksionojnë sa duhet.

Faleminderit!

**Ulsi Manja**- Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Naco, fjala për ju.

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti kryetar!

Sigurisht që qëllimi i projektligjit është pozitiv, por është klienteslit. E them që është klientelist, sepse këtu kemi një propozim nga një deputet, i cili ka sjellë një...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, opozita fjalët: “klientelist”, “oligarkë”, “korrupsion” apo “i korruptuar” i ka si certifikatë, i ka inflacion.

Mund të vazhdoni, zoti Naço.

**Nasip Naço** – Faleminderit, kryetar!

E thashë që nisma e deputetit ka qenë pozitive, sepse ka dashur të zgjidhë një situatë në një bashki apo komunë të caktuar. Projektligji i ardhur prej tij nga është ndryshuar prej jush. Unë kam këtu atë që ka firmosur zoti Ruçi, relacionin e shoqëruar bashkë me projektligjin. Mbi tavolinë kemi një relacion dhe një draft tjetër të bërë nga relatori. Është një ndryshim 100%, nuk ka vetëm shtyrje të afatit, sepse, po të ishte vetëm shtyrja e afatit për ta zgjidhur, do të isha edhe unë dakord dhe do ta votoja, ashtu siç kam votuar edhe herët e tjera për ta shtyrë dhe për ta zgjidhur. Këtu janë bërë ndryshime thelbësore, prandaj thashë që projektligji është klientelist. Duhet të më mirëkuptojnë relatorët, nuk doja të fyeja askënd, ndoshta nuk e kanë kuptuar se çfarë bëjnë me propozimet.

Neni 1 i projektligjit, germa “d”, aty ku e shtoni afatin dhe thoni se familjet bujqësore si individë, të cilët përmbushin kushtet si më poshtë: nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjeve bujqësore, por kanë qenë banorë të fshatit, ku gjendet toka bujqësore, objekt i kalimit të pronësie,

sipas regjistrimit të gjendjes civile në datën 01.08.1991, por të mos kenë përfituar më parë tokë bujqësore...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

..që do thotë se të gjithë ata që kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjeve bujqësore përfitojnë nga ligji, por ju shtoni edhe ata që janë banorë të atij fshati deri në vitin 1991, por që kanë punuar diku tjetër. Mënyra se si e keni shtuar, nuk e ndalon atë që nuk ka qenë punonjës, por atë që ka qenë banor i atij fshati, të marrë tokë. Po marr si shembull rrethin e Durrësit, ku prej disa vitesh kam qenë drejtues i prokurorisë atje dhe mund të them se janë me qindra hektarë tokë të marra nga qytetarë, të cilët pretendonin se ishin punonjës të ndërmarrjeve bujqësore. Kolegu Hyseni tha se është shumë e thjeshtë për t'ua verifikuar dhe ua kemi verifikuar, sepse të gjithë që nuk kanë qenë në bordero dhe nuk kanë përfituar nga financa nuk përfitonin tokë, por i kanë marrë tokat në kundërshtim të plotë me ligjin. Me këtë që po bëni ju, prandaj thashë se është klientelist, po i legalizoni të gjitha këto toka të mara, të mbajtura në mënyrë të paligjshme. Po marr si shembull Durrësin, Vlorën, po lë Divjakën dhe po i besoj 100% kolegut Braçe, por nuk mund t'i besoj Vlorës, Dhërmiut dhe Sarandës dhe nga ato ndërmarrje bujqësore, përveç atyre që kanë qenë punonjës aty, të vijnë edhe të tjerët që janë banorë të atij fshati dhe të marrin tokë, të cilët do të hyjnë në një sherr të pafund midis vëllezërve, motrave e të gjithë të tjerëve aty. Qëllimi juaj nuk ishte të ndalonit sherrin, por qëllimi i këtij projektligji është klientelist, sepse doni të shtoni aty edhe ata që nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjeve bujqësore. Në qoftë se do ta bëni këtë, të tjerët nesër do të propozojnë edhe për ata që nuk kanë qenë në kooperativat bujqësore deri në vitin 1991 dhe nuk kanë përfituar tokë, të përfitojnë edhe ata dhe të fillojë një proces tjetër vëllavrasës. Tokat e ndërmarrjeve bujqësore janë tjetër gjë dhe tokat sipas ligjit nr.7501 janë tjetër gjë. Këto kanë interesa klienteliste dhe zoti Mediu ,ua citoi ligjin. Kjo që po bëni nuk është as më shumë dhe as më pak, por po legalizoni vjedhjet që janë bërë në këta 30 vjet në Shqipëri.

Faleminderit!

**Ulsi Manja**-Faleminderit, zoti Naço!

Para se t'ia jap fjalën përfaqësueses së ministrisë, zëvendësministres, a ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Zonja Gjeçi, fjala për ju.

**Ermira Gjeçi** – Faleminderit!

Për informacion, dua të ndaj me ju se përfitues nga këto dy ndryshime ligjore janë, mbi të gjitha, ata që e përdorin tokën bujqësore, ku njëra kategori e tyre kanë qenë banorë më 01.08.1991, të cilëve nuk u është transferuar gjendja civile më 01.08.1991, por kanë qenë banorë në atë datë, të cilët e përdorin tokën bujqësore dhe kategoria e dytë janë të gjithë ata, të cilët kanë qenë banues të fshatit, jo punonjës të ndërmarrjeve bujqësore, por kanë qenë, janë banues dhe e përdorin tokën bujqësore. Këto janë dy kategoritë, të cilat përfitojnë nga këto dy ndryshime ligjore. Pjesa më e rëndësishme e këtyre ndryshimeve ka të bëjë me përdorues të tokës bujqësore, ku toka bujqësore përdoret dhe sjell të ardhura në familjet e tyre bujqësore.

Lidhur me afatin, për informacion dua të ndaj me ju se çfarë është bërë në vitin 2018. Në vitin 2018, lidhur me aktet e marrjes së tokës në pronësi, Ministria e Bujqësisë ka qenë në rol koordinues me 61 bashkitë e vendit, në mënyrë që të suportojë në finalizimin e këtij procesi. Kanë qenë rreth 25 mijë raste, të cilat nuk arritëm t'i përfundonim deri më 31.12.2018, që ka qenë edhe afati ligjor për dhënien e aktit të marrjes së tokës në pronësi, por ndërkohë janë të gjitha kërkesat e fermerëve, të cilët nuk janë pajisur për arsye nga më të ndryshmet, qoftë edhe për problematika të tilla ligjore, siç është kjo që po përpiqemi të rregullojmë sot me propozimin që bën zoti Braçe. Të gjitha këto janë procese që kanë ngelur dhe nuk janë finalizuar. Nga momenti që fermeri bën kërkesën për t'u pajisur me aktin e marrjes së tokës në pronësi, deri në momentin e finalizimit, edhe sikur çdo gjë të kalojë dhe të jetë në rregull, do të duhet një afat tremujor që në të gjitha institucionet të merret informacion që kjo tokë të mos ketë pretendime nga pronarë të tjerë.

Me të gjitha ndryshimet që ne kemi bërë me disa VKM gjatë vitit 2018 dhe me ligjin e ri të proceseve tranzitorë, ne pretendonim të përfundonim të gjithë rastet që ishin në proces, por afati kohor nuk mjaftoi dhe, meqenëse kjo nuk u arrit, deputetët kërkuan më shumë kohë për t'u njohur me këtë. Prandaj ne ramë dakord që afati të shtyhet dhe të gjitha rastet t'i përfundojmë, ndërkohë të rregullojmë edhe disa raste, të cilat paraqesin ngërç për fermerët, që përdorin tokën bujqësore.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Gjeçi!

Kalojmë në votimin e dy projektligjeve në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Vazhdojmë me projektligjin e parë "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar". Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim? 2 kundër. Abstenim nuk ka. 1 nuk mori pjesë në votim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen. Kush është dakord me nenin 1, me sugjerimet për riformulimin e bërë nga relatorët? Kundër? Abstenim? 2 kundër. Abstenim nuk ka. 1 nuk mori pjesë në votim.

Miratohet neni 1, me ndryshimet e propozuara për këtë nen nga relatorët.

Kalojmë te neni 2. Kush është dakord me nenin 2, me ndryshimet që propozohen nga relatorët? Kundër? Abstenim? 2 kundër. Abstenim nuk ka. 1 nuk mori pjesë në votim.

Miratohet.

Nga relatorët propozohet të shtohet neni 2/1, që është dispozitë kalimtare. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

1 kundër. Abstenim nuk ka. 1 nuk mori pjesë në votim.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3 “Hyrja në fuqi”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi me projektligjin me ndryshimet që propozojnë relatorët për secilin nga nenet? Kundër? Abstenim? 1 kundër. Abstenim nuk ka. 1 nuk mori pjesë në votim.

Miratohet në tërësi projektligji "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar".

Kalojmë te projektligji “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar". Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. 1 nuk mori pjesë në votim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen. Kush është dakord me nenin 1, me ndryshimet e propozuara për këtë nen nga relatorët? Kundër? Abstenim? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. 1 nuk mori pjesë në votim.

Miratohet.

Te neni 1 ka një propozim nga relatorët për t'u shtuar neni 1/1. Kush është dakord me shtimin e këtij neni, me formulimin përkatës? Kundër? Abstenim? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. 1 nuk mori pjesë në votim.

Miratohet.

Ka një propozim nga relatorët, të cilët propozojnë të shtohet neni 1/2 , që është dispozitë kalimtare. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. 1 nuk mori pjesë në votim.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2 “Hyrja në fuqi e ligjit”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar" me ndryshimet përkatëse të propozuara nga relatorët dhe të miratuara në Komisionin e Ligjeve.

Dua t'u kërkoj relatorëve dhe këshilltarëve që të dyja projektligjet, së bashku me raportin përkatës me sugjerimet e Komisionit të Ligjeve t'i kalojnë Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, i cili është komision përgjegjës.

Me miratimin e këtyre ndryshimeve mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Faleminderit dhe ditë të mbarë edhe përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Bujqësisë.!

Mbledhja e radhës do t'u njoftohet deputetëve si zakonisht!

Faleminderit!

**MBYLLET MBLEDHJA**

